



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KOMITETI KËSHILLDHËNËS PËR ETIKË GJYQËSORE

KKEGJ. Nr. 1/2024

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore (KKEGJ), në bazë të nenit 10.1, të Rregullores nr. 01/2022, për themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore, duke vendosur lidhur me kërkesën e gjyqtarit të një gjykate të Republikës së Kosovës, të datës 27 mars 2024, jep këtë:

OPINION KËSHILLDHËNËS

Për standardet etike të zbatueshme, të sjelljes së gjyqtarit jashtë zyrës së tij, me theks të veçantë për pjesëmarrje në lojëra të ndryshme shpërblyese

I. Baza ligjore

Komiteti Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore (KKEGJ), është themeluar nga KGJK-ja me Vendimin KGJK.nr.10/2022, të datës 21 janar 2022, duke u bazuar në Rregulloren nr.01/2022 e aprovuar nga KGJK-ja, po ashtu me datë 21 janar 2022.

Mandati dhe fushëveprimi i KKEGJ është përcaktuar me Rregulloren në fjalë.

Sipas nenit 1, paragrafi 2, të Rregullores, “ 2. Ky Komitet do ti ndihmoj gjyqtarët me informacione dhe këshilla rreth pyetjeve apo çështjeve etike të identifikuara për interpretim në lidhje me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtar dhe Ligjit të Procedurës Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve”.

Sipas nenit 1, paragrafi 3, të kësaj rregullore ”3. Komiteti do të shërbej si platformë ku gjyqtarët mund të këshillohen si ti trajtojnë situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarët “.

Rregullorja në fjalë në nenin 6, paragrafi 1, ka përcaktuar ” 1. Kryetarët dhe gjyqtarët e të gjitha niveleve të gjykatave, mund ti drejtohen Komitetit me kërkesa për dhënie të opinioneve, lidhur me situatat apo sjelljet e ardhshme të cilat mund të konsiderohen në kundërshtim me Kodin e Etikës Profesionale për Gjyqtarë ”.

II. Përmbajtja e kërkesës së gjyqtarit

Gjyqtari i gjykatës përkatëse, (KKEGJ në bazë të nenit 3, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të Rregullores do e ruan konfidencialitetin e emrit të gjyqtarit) në kërkesën e datës 21 shkurt 2024, të dërguar në adresën elektronike të KKEGJ, ka paraqitur një situatë hipotetike të ardhshme, në të cilën ka mundësi të gjendet gjyqtari në jetën e tij private. Ky gjyqtar në kërkesën e tij ka përshkruar një situatë hipotetike si vijon:

”Një biznes i caktuar në Kosovë e shpallë një lojë shpërblyese, e cila është në pajtim të plotë me legjislacionin e Kosovës dhe në këtë lojë shpërblyese mund të marrë pjesë në mënyrë të barabartë çdo qytetar i Republikës së Kosovës. Kusht i pjesëmarrjes në lojën shpërblyese është pagesa paraprake e një shume të caktuar simbolike e hollave ose blerja e produkteve të atij biznesi. Kusht tjetër është që qytetari të aplikoj, të dorëzoj ose regjistroj të dhënat e tij për tu bërë pjesë e lojës. Sipas rregullave të lojës shpërblyese, tërheqja e fituesit bëhet me transparencë të kënaqeshe dhe varet nga fati, si dhe të fund të tërheqjes publikohen të dhënat e fituesit ”.

Për ta sqaruar më qartë, ta marr një shembull të situatës së caktuar më lartë: një market për festat e fund vitit 2025 e shpallë një lojë shpërblyese, në të cilën mund të marrë pjesë çdo qytetar i Kosovës, i cili ka blerë produkte në atë market në shumë prej së paku 50€. Gjithashtu për të marrë pjesë, qytetari duhet që në një kuti të mbyllur ta fus kuponin e tij fiskal ose një tiketë që e vërteton blerjen në shumën e kërkuar. Identifikimi bëhet përmes emrit, mbiemrit, numrit të telefonit, por mund të jetë edhe vendi i prejardhjes së pjesëmarrësit. Përzgjedhja e fituesit bëhet përmes përzgjedhjes së kuponit fiskal/tiketës nga kutia në të cilën janë grumbulluar të gjithë kuponët fiskal/tiketat përmes një punëtorit të marketit, ose përmes një programi kompjuterik të marketit. Në të dy këto mënyra, fati është përcaktues i fituesit. Fituesi e fiton një send të caktuar (banesë, automjet, motoçikletë, telefon, të holla, voucher etj.) ose ndonjë shërbim (kryerja e punëve të caktuara, udhëtim etj.). Përveç kësaj, fituesi duhet që pasi ta marr çmimin, përmes mediave ose rrjeteve sociale të identifikohet dhe të tregoj se është fitues në lojën shpërblyese”.

Lidhur me këtë situatë hipotetike të ardhshme, gjyqtari i ka parashtruar për KKEGJ, këto pyetje:

1. A ka të drejtë gjyqtari të marrë pjesë në lojëra shpërblyese, të ligjshme dhe me mundësi pjesëmarrjeje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës?
2. Nëse ka të drejtë të marrë pjesë, a nënkupton kjo se ka të drejtë ta pranoj shpërblimin?

3. Nëse e pranon shpërblimin gjyqtari, a duhet ai të kërkoj përjashtimin nga lëndët, në të cilat marketi është palë?
4. Nëse duhet gjyqtari të kërkoj përjashtimin nga lënda, ose ta njoftoj palën kundërshtare për rrethanat dhe t'i jap mundësi atij që të kërkoj përjashtimin, atëherë sa do të ishte kohëzgjatja adekuate për të kërkuar përjashtimin me vetiniciativë ose të njoftoj palën kundërshtare për rrethanat e lojës shpërblyese?

Tutje ky gjyqtar ka kërkuar që nëse KKEGJ vlerëson të sqaroj edhe ndonjë çështje/pyetje tjetër nga ato katër të parashtruara më lartë, atëherë ka kërkuar ”që të mos ndjeni të kufizuar në këtë drejtim, meqë edhe Rregullorja nr. 01/2022 për Themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë Gjyqësore (këtu e tutje RrThKKEGj) nuk ka paraparë një ndalesë të tillë, përkundrazi ajo mundëson dhënien e opinioneve këshillëdhënëse të etikës me vetiniciativë”.

Më tej gjyqtari në kërkesën e tij ka vlerësuar se ”kjo çështje e prek potencialisht një numër të madh të gjyqtarëve, meqenëse edhe gjyqtarët janë pjesë e shoqërisë konsumuese në Kosovë, rrjedhimisht ekziston nevoja për sqarimin e kësaj dileme”.

Kjo kërkesë është e pranueshme në bazë të nenit 6, paragrafi 1, të Rregullores Nr.01/2022, për themelimin e Komitetit Këshillëdhënës për Etikë gjyqësore, pasi që është paraqitur nga gjyqtari që është subjekti i autorizuar, andaj KKEGJ këtë kërkesë do ta trajtoj në merita.

III. Standardet e zbatueshme ndërkombëtare lidhur me sjelljen e gjyqtarit jashtë zyrës së tij dhe detyrën e ruajtjes së integritetit gjyqësor

Parimet e sjelljes gjyqësore të miratuara në Bangalore të Indisë në vitin 2002¹, janë instrumenti ndërkombëtar më i plotë, i cili ka shërbyer si referencë për çështjen e trajtuar, qoftë në nivelin kombëtar, qoftë edhe në atë ndërkombëtar. Këto parime janë përcaktuar si vlera thelbësore që duhet të udhëheqin çdo gjyqtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Të njëjtat parime (*pavarësia, paanësia, integriteti, sjellja korrekte e gjyqtarit, barazia, si dhe kompetenca, profesionalizmi dhe korrektësia*), janë inkorporuar si vlera themelore edhe në Kodin e Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Gjyqtarëve, i miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Gjatë përgatitjes së opinionit, KKEGJ ka shqyrtuar dhe ka marr për bazë edhe disa dokumente tjera ndërkombëtare, të cilat ndërlidhen me çështjen etike të parashtruar, e posaçërisht: “Parimet themelore të pavarësisë së gjyqësorit” të Kombeve të Bashkuara (1985)², Rekomandimin Nr. R (94) 12 të Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës më pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve; Aktin Evropian mbi Statutin e Gjyqtarëve (1998) (DAJ/DOC(98)23); Kodin e mirësjelljes gjyqësore, drafti Bangalore, Opinionin nr. 3 i Këshillit Këshillëdhënës të Gjyqtarëve Evropian, KKGjE (2002) Op. Nr 3, datë 19 Nëntor 2002, etj. Të gjitha këto dokumente

¹ Bangalore Principles of Judicial Conduct (2002).

² I rishikuar në nëntor 2002 për t'u shndërruar në Parimet e Bangallore të Mirësjelljes Gjyqësore.

ndërkombëtare në përmbajtjen e tyre i kushtojnë rendësi të veçantë integritetit të gjyqtarit dhe sjelljeve që ai duhet ti shfaqë në jetën e tij private.

Parimet bazë mbi pavarësinë e gjyqësorit përcaktojnë se *”Gjyqtarët e zgjedhur në zyrën gjyqësore duhet të jenë persona me integritet dhe aftësi të trajnuar në mënyrë të duhur apo të kualifikuar me ligj...”*

Grupi i Integritetit Gjyqësor në mbledhjen e mbajtur me 21 dhe 22 janar 2010, në Lusaka, Zambia, ndër Masat për implementimin efektiv të Parimeve Bangalore të Sjelljes së gjyqësorit, ka përcaktuar që *”personat e përzgjedhur në zyrë të gjyqësorit duhet të jenë individ me aftësi, ndershmëri dhe efikasitet si dhe me trajnim të duhur apo kualifikim në drejtësi”*.

Deklarata e Parimeve të Pavarësisë së Gjyqësorit e aprovuar nga Konferenca e Kryetarëve të Gjykatave të Larta të Evropës Qendrore dhe Lindore, e aprovuar me 14 tetor 2015, në Brijuni, Kroaci, në pikën e 8 ka paraparë që *”Gjyqtarët duhet të mbështesin integritetin dhe pavarësinë e gjyqësorit dhe fitojnë besimin e popullit duke shmangur sjellje të pahijshme dhe shfaqjen e sjelljes së pahijshme në të gjithë veprimtarin e tyre zyrtare dhe private”*.

Rekomandimin Nr. R (94) 12 i Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës më pavarësinë, efikasitetin dhe rolin e gjyqtarëve ka përcaktuar se *”Gjykatësit duhet të kenë pushtet të mjaftueshëm dhe të jenë të aftë të realizojnë atë me qëllim që të zbatojnë detyrat e tyre dhe të ruajnë autoritetin dhe dinjitetin e tyre në gjykatë”*.

Opinionin nr. 3 i Këshillit Këshillëdhënës të Gjyqtarëve Evropian, KKGJE (2002) Op. Nr 3, datë 19 Nëntor 2002, në pikën 29 ka potencuar *”Gjyqtarët duhet të sillen në mënyrë të respektueshme në jetën e tyre private”*.

Në Opinionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të Shqipërisë për standardet etike të zbatueshme, në rastin e përdorimit të mediave sociale nga gjyqtarët, ndër të tjera thuhet se *”Pritshmëritë e publikut për integritetin e gjyqtarëve janë shumë të larta. Sjellje të caktuara që mund të jenë të pranueshme për publikun, konsiderohen jo të pranueshme nga gjyqtarët apo pjesëtarët e gjyqësorit në përgjithësi. Gjyqtarët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për mënyrën se si sjellja e tyre mund të perceptohet nga individ të arsyeshëm dhe të informuar në komunitet, si dhe nëse ky përcaktim do të ndikoj në uljen/cenimin e respektit për gjyqtarët apo gjyqësorin në tërësi. Çdo sjellje që cenon apo ul respektin në sytë e publikut për gjyqtarët/gjyqësorin, duhet shmangur nga gjyqtarët”*.

IV. Rregullativa ligjore vendore lidhur me sjelljen e gjyqtarit jashtë zyrës së tij dhe detyrën e ruajtjes së integritetit gjyqësor

KKEGJ konstaton se në Republikën e Kosovës, është miratuar rregullativë ligjore adekuate, e cila normon detyrimin e gjykatave, përkatësisht gjyqtarëve që në punën e tyre të jenë të pavarur, të paanshëm dhe ta ruajnë integritetin profesional të tyre, dhe integritetin e sistemit gjyqësor në përgjithësi.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 102 paragrafin 4, Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor, ka përcaktuar se *”Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit të tyre duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm”*.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodi i Etikës Profesionale për Gjyqtarë, parashohin dispozita me të cilat rregullohen përgjegjësitë dhe detyrat të cilat i kanë autoritetet publike, e ndër ta edhe gjyqtarët në ushtrimin e funksionit gjyqësor, përfshirë këtu edhe detyrat që ndërlidhen me ruajtjen e integritetit gjyqësor.

Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në neni 5, paragrafi 2, nënpika 2.15, si shkelje e detyrave të gjyqtarit përcaktohet nëse gjyqtari *” 2.15, përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës, ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit ”*.

Edhe Ligji për Gjykatat (Ligji Nr.06/L-054), në dispozitën e nenit 41 paragrafi 1, ka përcaktuar se *”Gjyqtarët nuk kryejnë asnjë detyrë apo shërbim që mund të perceptohet si ndërhyrje në pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre, apo që përndryshe nuk është përputhje me detyrat e një gjyqtari, apo dispozite të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë në Kosovë ”*.

Kodi i Etikës Profesionale të Gjyqtarëve, i hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të cekura më lartë, në nenin 4, kërkon *”Gjyqtari sillet në mënyrë të ndershme, të dinjitetshme dhe duhet të jetë gjatë tërë kohës në harmoni me karakterin e lartë moral, i cili është thelbësor për ruajtjen e reputacionit të gjyqësorit ”*.

Ky Kod në nenin 4, paragrafi 4.1, ka përcaktuar se *”Gjyqtari si bartës i funksionit të rëndësishëm publik dhe që i nënshtrohet vazhdimisht mbikëqyrjes nga publiku, sipas vullnetit të lire pranon kufizimet që i imponon funksioni që ushtron”*.

Në nenin 4, paragrafi 4.2, të këtij Kodi përcaktohet se *”Gjyqtari sillet në atë mënyrë që afirmon besimin e publikut dhe integritetin e sistemit gjyqësor ”*.

Ndërkaq në nenin 4, paragrafi 4.4, të këtij kodi përcaktohet se *”Gjyqtari nuk do të lejoj që interesat e tij financiare dhe të familjes së tij të ngushtë të ndikojnë negativisht në integritetin e funksionit të cilin e ushtron ”*.

V. Vështrime në kontekstin e çështjes etike të parashtruar nga gjyqtari

Gjyqtari gjatë kryerjes së detyrave të tij ka për detyrim të ruaj integritetin e tij dhe të gjyqësorit në përgjithësi, në kontekst të sjelljeve që ai mund ti shfaq jashtë zyrës së tij, në jetën e tij private. Një gjyqësor efektiv dhe i pavarur, kërkon standarde dhe integritet të lartë të gjyqtarëve, me qëllim realizimin e misionit të tyre, e që ka të bëjë me dhënien e drejtësisë. Në funksion të kësaj, respektimi i rregullave të sjelljes nga ana e gjyqtarëve gjatë kohës sa e ushtrojnë këtë funksion në

zyrën gjyqësore të tij apo jashtë saj, ndikon drejtpërsëdrejti në garantimin që të kemi një sistem me integritet të lartë gjyqësor.

Mirëbesimi në publik dhe respekti për gjyqësorin janë garancion të efektivitetit të sistemit gjyqësor, ndërsa sjellja e gjyqtarëve në aktivitetet e tyre profesionale, dhe gjatë jetës private, konsiderohet nga anëtarët e publikut si thelbësore për kredibilitetin e gjykatës. Në këtë vështrim, për gjyqtarët është e rëndësishme të kuptojnë jo vetëm kufijtë që ligji ka përcaktuar në ushtrimin e funksionit të tyre, por edhe standardet e sjelljes që ata janë të detyruar të respektojnë.

Prestigji i sistemit gjyqësor është thelbësor në një sistem demokratik, në një shtet të së drejtës, ku gjyqësori ushtron pushtetin e tij si i pavarur. Sjellja e gjyqtarëve gjatë kohës sa ai qëndron në zyrën e tij dhe gjatë kohës në jetën e tij private, vlerësohet se është e lidhur ngushtë me rritjen e besimit në integritetin e gjyqësorit në tërësi. Kjo arritje, do të cenohet në rastin kur gjyqtari me vetëdije apo edhe pa vetëdije, lejon ngritjen e paragjykimëve mbi mënyrën se si ai e ushtron funksionin e tij. Gjyqtari me sjelljen e tij jo vetëm në zyrën e tij por edhe gjatë jetës private, ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Gjyqësori i pavarur dhe i dinjitetshëm me integritet të lartë gjyqësor, është i domosdoshëm për drejtësinë në shoqërinë tonë. Gjyqtari ka për obligim të ruajë dhe zbatojë standarde të larta sjelljeje jo vetëm për kohën sa qëndron në zyrën e tij, por edhe gjatë jetës së tij private, krejt në funksion të ruajtjes së integritetit dhe pavarësisë së gjyqësorit. Gjyqtari nuk duhet që as të shfrytëzojë integritetin e detyrës gjyqësore për të shtyrë përpara interesat private të tij apo të tjerëve, e as të krijojë, por as t'i lejojë të tjerëve të krijojnë përshtypjen se janë në ndonjë pozitë të caktuar për të ndikuar tek gjyqtari. Besimi i publikut në gjyqësor do të dobësohet nga sjelljet e gjyqtarit që bien ndesh me rregullat e Kodit të Etikës së Gjyqtarëve, pasi publiku sjelljet e tilla i percepton si diçka që cenon integritetin e sistemit gjyqësor. Gjyqtari duhet ta dijë që vazhdimisht gjatë tërë kohës sa e kryen këtë funksion, do t'i nënshtrohet vështrimit publik dhe ai duhet të jetë i gatshëm që të pranojë lirshëm dhe me dëshirë kufizime të ndryshme që mund të shihen si ngarkesë nga një qytetar i rëndomtë.

Gjyqtari në kërkesën e tij ka parashtruar pyetjen e parë, *"A ka të drejtë gjyqtari të marrë pjesë në lojëra shpërblyese, të ligjshme dhe me mundësi pjesëmarrjeje për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës?"*

Në lidhje me pyetjen e parashtruar si më lartë, KKEGJ vlerëson se në bazë të rregullave të Kodit të Etikës për Gjyqtar të përmendura si më lartë, gjyqtari dhe familja e tij e ngushtë, nuk duhet të marrin pjesë në lojëra shpërblyese, përkatësisht duhet të shmangen nga marrja pjesë në lojëra të tilla, edhe nëse ato janë të ligjshme, pasi që një veprim i tillë bie ndesh me këtë Kod dhe mund të dëmtojë reputacionin e gjyqtarit në veçanti, por edhe të vet sistemit të drejtësisë në përgjithësi.

Siç dihet gjyqtari është një figurë e njohur për publikun, ai është nën vëzhgim publik nga shumë akter të shoqërisë. Gjyqtari me një veprim të tillë do të rrezikon që ti cenohet integriteti i tij personal, e po ashtu një veprim i tillë tek publiku do të perceptohej si diçka që do mund të dëmtonte edhe integritetin e sistemit gjyqësor në përgjithësi.

Veprimet e tilla në lojërat shpërblyese të ligjshme, siç dihet janë të lejuara për qytetarët e rëndomtë, por jo edhe për gjyqtarët që janë figura të rëndësishme publike, dhe kryejnë funksion të rëndësishëm siç është ndarja e drejtësisë për qytetarët. Në lidhje me këtë, Kodi i Etikës Profesionale për gjyqtar qartazi në nenin 4, nënparagrafi 4.1, ka përcaktuar se gjyqtari si bartës i funksionit të rëndësishëm publik dhe që i nënshtrohet vazhdimisht mbikëqyrjes nga publiku, sipas vullnetit të lirë pranon kufizimet që i imponon funksioni që ushtron. Gjyqtarët kanë përgjegjësi ligjore dhe etike jo vetëm ta ruajnë, por edhe ta avancojnë integritetin e sistemit gjyqësor.

Gjyqtari me faktin se ka pranuar ta ushtron këtë funksion, ai është i obliguar me ligj dhe me rregulla të Kodit të Etikës që për gjatë tërë mandatit të tij, ti nënshtrohet domosdo jo vetëm ai, por edhe familja e tij e ngushtë disa kufizimeve, të cilat kufizime kryekëput kanë për qëllim dhe janë në funksion të ruajtjes së integritetit të gjyqtarit, por edhe të integritetit të sistemit gjyqësor në përgjithësi.

Kufizimet mund të jenë të ndryshme, disa të përcaktuara me ligj, të tjerat me rregulla të Kodit të Etikës për Gjyqtar, por të cilat duhet të zbatohen jo vetëm gjatë kohës sa gjyqtari qëndron në zyrën e tij, por edhe gjatë jetës së tij private. Një ndër kufizimet e tilla është edhe kjo që ndërlidhet me çështjen e parashtruar nga gjyqtari e që ka të bëjë me pjesëmarrjen e gjyqtarëve në lojëra shpërblyese, të organizuara nga subjekte të ndryshme afariste.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në një lojë shpërblyese edhe nëse është e ligjshme, e cila organizohet nga një biznes i caktuar në Kosovë, apo nga ndonjë subjekt apo person juridik tjetër, do të krijonte mundësinë që tek publiku i cili vazhdimisht e vëzhgon gjyqtarin, të krijohet përshtypja apo perceptimi se pavarësia dhe paanshmëria e gjyqtarit, është vënë në rrezik, pasi që biznesi apo kushdo që e ka organizuar lojën shpërblyese, nëse sot nuk është palë, nesër mund të jetë palë në procedurë.

Akti i pjesëmarrjes në lojëra të tilla shpërblyese, krijon mundësin nëse ecë fati personal, që pjesëmarrësi i lojës të dalë edhe fitues i lojës. Kjo pastaj krijon situatën tjetër jo të lakmueshme, madje jo të lejueshme për gjyqtarët, që ai ti ekspozohet publikut për mes mediave apo rrjeteve sociale gjatë aktit të pranimit të shpërblimit të lojës, që e jep organizatori i lojës. Vlera e shpërblimit të pranuar në këtë mënyrë, po ashtu ka rëndësi dhe konsiderohet të jetë faktor i rëndësishëm që ndikon në dëmtimin reputacionin të gjyqtarit, në publik, por mund të ketë edhe pasoja tjera ligjore të cilat ndërlidhen me ndalesat e zyrtarëve të lartë publik për pranimin e shpërblimeve të ndryshme gjatë mandatit të tyre.

Përveç kësaj, mund të krijohet edhe perceptimi tjetër negativ nga publiku, edhe për mënyrën e organizimit, përkatësisht për zgjedhjes së fituesit të lojës shpërblyese, e që mund të ndërlidhet me përshtypjen se për shkak të pozitës së tij si gjyqtar i njëjti edhe është favorizuar për marrjen e shpërblimit të caktuar. Për këto arsye është vlerësim i KKEGJ-së se gjyqtari duhet të shmang

situatat e tilla të cilat për pasojë mund të kenë perceptim negativ nga publiku dhe me këtë do të dëmtohej në masë të madhe reputacioni i gjyqtarit në veçanti, por edhe i vet sistemit të drejtësisë në përgjithësi. Gjyqtarët duhet të jenë të ndërgjegjshëm për mënyrën se si sjellja e tyre mund të perceptohet nga individ të arsyeshëm dhe të informuar në komunitet, si dhe nëse ky përcaktim do të ndikoj në uljen/cenimin e respektit për gjyqtarët apo gjyqësorin në tërësi. Çdo sjellje që cenon apo ul respektin në sytë e publikut për gjyqtarët/gjyqësorin, duhet shmangur nga gjyqtarët.

Prandaj veprimet e tilla gjyqtari dhe familja e tij e ngushtë, gjatë gjithë kohës sa zgjatë mandati i gjyqtarit duhet të parandalohen, nga se sjelljet dhe veprimet e gjyqtarit dhe të familjes së tij të kësaj natyre, është e qartë se bien ndesh me nenin 4, nënparagrafët 4.1, 4.2 dhe 4.4, të Kodit të Etikës profesionale për gjyqtar. Gjyqtari në kërkesën e tij ka parashtruar edhe pyetje tjera, në të cilat pyetje KKEGJ, me këtë rast nuk do të jap përgjigje, duke vlerësuar se dhënia e përgjigjes në pyetjen e parë të parashtruar i konsumon të gjitha përgjigjet edhe për pyetjet tjera të ngritura.

VI. Konkluzioni

KKEGJ, vlerëson se në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të rregullave të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar, gjyqtari apo anëtarët e ngushtë të familjes së tij, gjatë tërë kohës së mandatit të tij, duhet të përmbahen nga pjesëmarrja në lojërat e organizuara shpërblyese edhe nëse ato janë të ligjshme, të cilat mund të organizohen nga kushdo qoftë, biznes, subjekt apo person juridik.

Shmangia me vetëdije apo pa të nga respektimi i këtij detyrimi etik, mund të paraqet shkelje etike të gjyqtarit, pasi që të njëjtat vlerësohen të jenë në kundërshtim me nenin 5.2 nën paragrafi 2.15 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Nr.06/L-057, dhe me nenin 4, paragrafët 4.1, 4.2 dhe 4.4, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtar.


Kryetari i Komitetit,
Muhamet Rexha